



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 62

Tiranë – E mërkurë, 29 mars 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 221, datë 21.3.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1532, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë, të qarkut të Korçës”, të ndryshuar..... 3535
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 224, datë 21.3.2017	Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë..... 3539
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 225, datë 21.3.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 432, datë 13.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, të ndryshuar..... 3546
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 226, datë 21.3.2017	Për financimin e kostos së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit..... 3547
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 227, datë 21.3.2017	Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore..... 3547
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 228, datë 21.3.2017	Për disa shtesa në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 3548
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 21.3.2017	Për rishpërndarje fondesh të infrastrukturës vendore dhe rajonale, nga Ministria e Zhvillimit Urban në disa njësi të qeverisjes qendrore..... 3548



VENDIM

Nr. 221, datë 21.3.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1532, DATË 19.11.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KORÇË, TË QARKUT TË KORÇËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “a”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1532, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në listën e inventarit, për pronën me numrin rendor 665 ndryshohen emërtimi dhe sipërfaqja, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi.

b) Prona me numër rendor 665 i shtohet lidhjes 1 në fushën e pronave që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative.

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

Per inventarizimin e pronave te vecanta)


Institucioni i Pushtetit Qendror											
Bashkia: KORÇË											
Fusha e perdorimit te Prones: Administrative											
Nr. Rend.	A			B			C				
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Truallit (m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m ²)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)	
665	8564 Ko-N-9	2\12	Ndertese +Truall	Ish Prokuroria e Rrethit Korçe. Bul.28 Nendori	1770.2	318.725	Administrata	Ish Prokuroria e Pergjithshme	Bashkia	Bashkisë Korçë do ti kalojë në pronësi ambientet ku ka ushtruar funksionet Prokuroria Korçë ne sip. ndërtese 318.725 m2(sip gjurme) + 349.6 m2 (sip.kati.i l-rë)= 668.325 m2. dhe trualli funksional me sip. 1561.6 m2 (truall i përbashket, pas. 2/10)+1770.2 m2 (truall pas. 2/12)=3331.8 m2. Këto ambiente do të përdoren si zyra ku ushtron funksionet Bashkia Korçë dhe trualli do te jete në funksion të tyre. Sqarojmë se me kontratën e shkëmbimit me M.Drejtësisë Nr.1742 Rep. dt. 29.06.2009 Bashkisë i kalojnë në pronësi ish ambientet ku ka ushtruar funksionet Gjykata e Rrethit Korçë.	
	8564 Ko-N-9	2/10	Truall funksional	Ish Prokuroria Ish Gjykata Bashkia	1561.6		Administrata	Ish Prokuroria e Pergjithshme	Bashkia		







BASHKIA KORÇË
PLANIMETRIA E KATIT TE PARË



ISH AMBIENTET E PROKURORISË
SIPËRFAQJA 349.6 m²

**VENDIM****Nr. 224, datë 21.3.2017****PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE
SHITESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE
AKTIVË TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të nenit 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi bëjnë pjesë:

a) ushtarakët e shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura: oficerë, nënoficerë aktivë dhe ushtarë aktivë;

b) kursantët, kandidatët për ushtar.

2. Struktura dhe nivelet e pagës bazë për gradë, sipas gradës dhe viteve të shërbimit, për ushtarakët aktive të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Struktura dhe nivelet e pagave për ushtarakët aktivë të personelit akademik, të cilët janë të punësuar me kohë të plotë në Akademinë e Forcave të Armatosura, janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ushtarakët aktivë të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë në Akademinë e Forcave të Armatosura, të cilët trajtohen në pagë sipas lidhjes nr. 2, përfitojnë shtesë për vjetërsi në punë, në masën 0,5 % për çdo vit pune, por jo më shumë se 15 vjet.

5. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura përfitojnë shtesë mbi pagë për kushte të veçanta pune e shërbimi. Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi është, si më poshtë vijon:

a) Për personelin fluturues të Forcave të Armatosura, sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Për ushtarakët aktivë në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Pozicionet në funksione operacionale, operacionale mbështetëse dhe mbështetëse, për të cilat zbatohet kjo shtesë në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit për miratimin e strukturës e të organikës së kësaj agjencie.

c) Për ushtarakët e tjerë aktivë të Forcave të Armatosura, të cilët nuk janë pjesë e lidhjeve nr. 3 dhe nr. 4, sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, të cilët punojnë në vende të vështira pune, përfitojnë shtesë mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ushtarakët, funksioni i të cilëve përmban dy apo më shumë emërtime që përfitojnë shtesë për punë të vështirë e të dëmshme në shëndet, të trajtohen vetëm me një shtesë sipas kësaj lidhjeje.

Ushtarakët aktivë në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës, në pozicionet “Drejtor”, “Zëvendësdrejtor”, “Shef shërbimi” apo “Shef repartit”, të përfitojnë shtesë për punë të vështirë e të dëmshme në shëndet, sipas specialitetit dhe jo sipas pozicionit.

7. Oficerët aktivë të Forcave të Armatosura, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së Forcave të Armatosura, pjesë të strukturave të TIK dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit “Master i Shkencave/Master Profesional /Bachelor” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike”, “Inxhinieri informatike”, “Informatikë”, “Teknologji informacioni”, “Inxhinieri telekomunikacioni”, “Shkenca kompjuterike”, “Informatikë ekonomike” apo “Inxhinieri matematike informatike”, përfitojnë shtesë për natyrë të veçantë pune, në masën 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

Zbatimi i shtesave si më sipër për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe të Ministrisë së Financave, bazuar në përshkrimin e pozicionit të punës.



Në rast se për pozicionet e sipërpërmendura parashikohen shtesa të tjera për kushte të veçanta pune e shërbimi, oficerët aktivë do të zgjedhin ndërmjet dy shtesave, por, në asnjë rast, nuk mund t'i përfitojnë të dyja shtesat.

8. Kursantët, kandidatë për ushtar, gjatë kohës që ndjekin kurset për t'u certifikuar ushtar, përfitojnë trajtim me pagesë, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.

9. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, të përcaktuara me vendime të tjera të Këshillit të Ministrave.

10. Vendimi nr. 839, datë 11.12.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i të këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes, për vitin 2017.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

PAGA BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA																
OFICERË	P.bazë	Vitet e shërbimit														
		Mbi 1 vit	Mbi 2 vjet	Mbi 3 vjet	Mbi 4 vjet	Mbi 6 vjet	Mbi 8 vjet	Mbi 10 vjet	Mbi 12 vjet	Mbi 14 vjet	Mbi 16 vjet	Mbi 18 vjet	Mbi 20 vjet	Mbi 22 vjet	Mbi 24 vjet	Mbi 26 vjet
Gj.Lejtnant (Admiral)																169500
Gj.Major (Nenadmiral)																162000
Gj.Brigade (Kunderadmiral)																127500
Kolonel (Kapiten i rangut I-re)														106200	108400	110000
Nenkolonel (Kapiten i rangut II-te)												84100	85500	86800	88300	89700
Major (Kapiten i rangut III-te)									65500	66600	67700	69900	71000	72100	73200	74300
Kapiten (Kapiten lejtnant)						58500	59100	59800	60500	61200						
Toger (Lejtnant)				53500	54900	55900	57300	57900	58400	58900						
Nentoger (Nenlejtant)	49650	50150	50850	52050	52800	53300	53500									
Vitet e shërbimit																
NËNOFICERË	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26	
K/Kapter											58850	59950	61850	63050	64150	
Kapter								50400	52050	53050	53900	55350	57550	58100	58600	
Rreshter						45100	46550	48950	50400	52050	53050	53600				
Tetar						44150	45100	45650	46750							
Nentetar				40150	42500	44000	44500	45000	45250							
Vitet e shërbimit																
USHTARË AKTIVË	P.bazë	Mbi 1 vit	Mbi 2 vjet	Mbi 3 vjet	Mbi 4 vjet	Mbi 5 vjet	Mbi 6 vjet	Mbi 8 vjet	Mbi 10 vjet	Mbi 12 vjet	Mbi 14 vjet					
Ushtar IV/ Detar IV			38000	39300	41050	41700	42350	42850	43350	43850	44100					
Ushtar III/ Detar III		36850	38100													
Ushtar II/ Detar II	35200	36650														
Ushtar I/ Detar I	33600															



LIDHJA NR. 2
STRUKTURA DHE NIVELI I PAGAVE PËR USHTARAKËT AKTIVË TË PERSONELIT
AKADEMIK, NË AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA

Nr.	GRADA E FUNKSIONIT	Pozicioni	Paga
1	Kolonel (kapiten i rangut I)	Rektor/komandant	139.800
2	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zv./rektor, nga kategoria “Profesor”	132.200
3	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zv./rektor, nga kategoria “Docent/Doktor”	130.500
4	Kolonel (kapiten i rangut I)	Dekan nga kategoria “Profesor”	132.200
5	Kolonel (kapiten i rangut I)	Dekan nga kategoria “Docent/Doktor”	130.500
6	Kolonel (kapiten i rangut I)	Përgjegjësi i njësisë bazë nga kategoria “Profesor”	123.800
7	Kolonel (kapiten i rangut I)	Përgjegjësi i njësisë bazë nga kategoria “Docent/Doktor”.	106.700
8	Kolonel (kapiten i rangut I)	Titullar i grupit mësimor-kërkimor nga kategoria “Profesor”	123.800
9	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Titullar i grupit mësimor-kërkimor nga kategoria “Docent/Doktor”	106.700
10	Kolonel (kapiten i rangut I)	Profesor	121.000
11	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Profesor i asocuar	105,200
12	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Docent/Doktor	95.800
13	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Docent/Master	91.800
14	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Lektor/i parë/Kërkues i parë	90.300
15	Major (kapiten i rangut III)	Lektor/Kërkues	73.400
16	Kapiten (kapiten lejtant)		64.700

LIDHJA NR. 3
MASA E SHITESËS PËR KUSHTE TË VEÇANTA PUNE E SHËRBIMI PËR USHTARAKËT
AKTIVË FLUTURUES TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Nr.	Emërtimi i funksionit	Masa e shtesës mujore në lekë për muaj			
		Në skuadroni dhe grupe të helikopterëve në Bazën Ajrore Farkë të Forcave të Armatosura	Në strukturat e tjera të Bazës Ajrore Farkë të Forcave të Armatosura	Në strukturat e tjera të Forcave të Ajrore	Në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura
1	Pilot	40000	30000	20000	10000
2	Inxhinier fluturimi	28000	21000	14000	
3	Mekanik/teknik bordi	24000	18000	12000	
4	Infermier bordi Operator bordi Vinçier bordi	20000	15000	10000	
5	Inxhinier avioni/helikopteri	16000	12000	10000	
6	Kontrollor i trafikut ajror	12000	12000	12000	
7	Teknik avioni/helikopteri	12000	10000	10000	



LIDHJA NR. 4

MASA E SHITESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE DHE VËSHITRËSI SHËRBIMI PËR
USHTARAKËT AKTIVË NË AGJENCINË E INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË
MBROJTJES

Nr.		Emërtimi i funksionit (pozicioni)	Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune dhe vështirësi shërbimi, në lekë për muaj
1	Operacional	Përgjegjës sektori. Specialist/Inspektor. Ndihmës inspektor. Teknik i mesëm dhe administrator pajisjesh/Operator. Shofer autoveture, mjet operacional. Shofer autoveture/mjet operacional/Ndihmësinsektor.	15.000
2	Operacional Mbështetës	Drejtor i përgjithshëm. Zëvendësdrejtor i përgjithshëm. Drejtor drejtorie. Përgjegjës/ Shef sektori. Analist. Specialist. Operator dhe për administrimin e dokumentacionit. Operator radiozbulues. Teknik i mesëm/Operator radiozbulues. Roje me armë Kroi i Bardhë, Kukës. Roje me armë Çardhak, Korçë. Teknik i mesëm i Specialiteteve të ndryshme/shofer/Roje me armë Tarabosh, Shkodër. Teknik i mesëm/Operator/ Roje me armë Tarabosh, Shkodër. Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme. Shofer/Roje me armë M. Krujës, Krujë. Teknik i mesëm/Operator/Roje me armë/M. Krujës, Krujë.	10.000
3	Mbështetës	Për punonjësit në funksionet e tjerë ushtarake të AISM-së.	5.000

LIDHJA NR. 5

MASA E SHITESËS PËR KUSHTE TË VEÇANTA PUNE E SHËRBIMI QË PËRFTOJNË
USHTARAKËT AKTIVË NË FORCAT E ARMATOSURA

Nr.	Personeli ushtarak që përfiton shtesë për kushte të veçanta pune e shërbimi	Masa e shtesës (në lekë)
1	Mjekët që shërbejnë në FA. Parashutistët. Oficerët apo nënoficerët në detyrë dhe të kualifikuar si zhytës. Oficerët, nënoficerët apo ushtarët profesionistë të kualifikuar, që shërbejnë në njësitë e Asgjësimit me Eksploziv të Municioneve dhe që kryejnë operacione për shkatërrimin e municioneve dhe eksplozivëve. Oficerët, nënoficerët apo ushtarët profesionistë të emëruar në Batalionin Special Komando, të cilët kryejnë detyra taktike të Batalionit Special. Oficerët, nënoficerët apo ushtarët profesionistë të emëruar në Batalionin Komando, që kryejnë detyra taktike komando.	8000



2	Personeli ushtarak administrativ dhe ai i ndihmës, të emëruar në Batalionin Special Komando, por që nuk kryejnë detyra taktike të Batalionit Special. Personeli ushtarak administrativ dhe ai i ndihmës, të emëruar në Batalionin Komando, por që nuk kryejnë detyra taktike Komando; Oficerët, nënoficerët apo ushtarët profesionistë në Qendrën e Stërvitjes Bazë, që janë emëruar në funksione dhe që kryejnë direkt stërvitjen bazë. Personeli ushtarak i Qendrës së Stërvitjes Bazë deri në nivel Kompanie. Personeli ushtarak në strukturën e Rojës Bregdetare. Personeli ushtarak i Policisë Ushtarake, i cili angazhohet direkt në punën operative dhe funksionale që kryen Policia Ushtarake. Personeli ushtarak deri në nivel kompanie në Forcën Tokësore. Komandantët e batalioneve në Forcën Tokësore. Personeli ushtarak i Kurseve në Akademinë e Nënoficerëve	5000
3	Oficerët me specialitete detare të emëruar në pozicione organike, që kërkojnë kryerjen e lundrimeve dhe personeli ushtarak (oficer, nënoficer dhe ushtar profesionist) i emëruar në anije. Personeli ushtarak i Policisë Ushtarake që nuk përfshihet në numrin rendor 2. Personeli i Forcës Tokësore që nuk përfshihet në numrin rendor 2. Personeli ushtarak (drejtimi dhe trupa) në Orkestrën Frymore. Personeli ushtarak i Qendrës së Stërvitjes Bazë që nuk përfshihet në numrin rendor 2. Personeli ushtarak i kompanisë së rikonicionit të Forcave Tokësore. Personeli ushtarak i postave radioteknike dhe postave sinjal-vrojtuese, në Forcat Detare. Ushtarakë të tjerë në Akademinë e Nënoficerëve.	3000

LIDHJA NR. 6

FUNKSIONET USHTARAKE QË PËRFTOJNË SHITESË PËR PUNË TË VËSHTIRË E TË DËMSHME NË SHËNDET NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA

Nr.	Emërtimi i funksionit	Masa e shtesës në lekë
1	Në laboratorin e municioneve të Laboratorit Qendror të Forcave të Armatosura: Shef i laboratorit; Shef i seksionit; Teknolog kimist; Teknik i specialiteteve të ndryshme.	7,400
2	Në laboratorin e analizave kimike në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: Shef i laboratorit; Shef i seksionit; Specialist analizash; Specialist për sintezën; Teknolog kimist. Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Mjek anatomopatolog.	5,900
3	Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Mjek neurokirurg; Teknik për higjienën e ujit; Teknik për higjienën ushqimore: Inxhinier kimist; Mjek i laboratorit klinik biokimik; Kryelaborant klinik biokimik; Laborant klinik biokimik; Mjek histolog; Laborant histolog.	5,200
4	Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Teknik rendues; Ushtarakët që punojnë në rrjetet kompjuterike LAN/WAN; Ushtarakët në pikat e ritransmetimit, radiozbulimit dhe pikat e vrojtimit të qendëruara: Inxhinier elektronik; Informaticien. Në Forcat Ajrore: Asistent kontrollor trafiku ajror. Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Mjek i higjienës ushtarake dhe inspektor sanitar; Mjek toksikolog; Mjek neuropsikiatër; Kryeinfermier në shërbimin e neuropsikiatrisë; Mjek anesteziist reanimator; Ndihmës anesteziist; Kryeinfermier reanimacioni; Kryeinfermier dhe infermiere të sallave të operacionit të urgjencës dhe të reanimacionit kirurgjikal; Teknik për DDD (Dizinfektim, Deratizim, Dezinsektim); Prozektor. Në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: <u>Në seksionin e analizave kimike dhe laboratorin e analizave kimike:</u> Specialist i teknikës dhe aparaturës; Specialist ventilimi; Shofer i mjeteve speciale. <u>Në seksionin e intendencës në laboratorin bakteriologjik:</u> Shef i seksionit; Teknolog kimist; Biokimist. <u>Në seksionin e mjeteve të indikimit në laboratorin e analizave kimike:</u> Specialist për teknikën e aparaturës; Specialist përpunimi qelqi. <u>Në laboratorin e analizave kimike:</u> Magazinier. <u>Në laboratorin e municioneve:</u> Teknik/Shofer.	4,400
5	Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Magazinier; Nënoficer furnizimi që merret me	3,700



	karburante; Pilot avioni; Pilot helikopteri; Palombar (zhytës). Në strukturat xheniere: Manovrator dhe ndihmës manovrator i makinerive të rënda:(buldozer, eskavator, rulist, motorulist, vinçier, autovinçier etj.) Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Mjek radiolog; Mjek depistim radiologjik; Mjek pneumolog; Laborant teknik në shërbimin e radiologjisë; Oksigjenist; Elektracist; Specialist mirëmbajtjes pajisjeve mjekësore. Në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: Drejtor; Zv./drejtor. Në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes e Informacionit: Teknik kabllist i rrjetit të jashtëm; Radist; Radiorelist; Operator; Specialist SUE (stacioni i ushqimit elektrik)	
6	Në strukturat xheniere: Motokompresorist; Pistoletist; Ndihmës motokompresorist; Ndihmës pistoletist; Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Mjek fizioterapeut; Mjek hematolog; Mjek, kryeinfermier e infermier në shërbimin e urgjencës dhe të pranimit; Mjek infeksionist; Mjek reanimacion terapisë; Mjek epidemiolog; Teknikien i mjekësisë Forcave Ajrore(Aviacionit); Teknikien i mjekësisë Forcave Detare (Marinës); Masazhist në fizioterapi. Në Forcat Detare: Shef stacioni akustik; Instruktor; Laborant navigacioni; Radiometrist; Mirëmbajtës kuvertash; Nënoficeri planshetës operatore. Në Batalionin e Vëzhgimit Ajror: Komandanti i batalionit; Zv/komandanti i batalionit; Shef zbulimi i batalionit; Shef/Oficer shtabi operacional i batalionit; Specialist mirëmbajtje radar në batalion; Specialist mirëmbajtje radar në qendrat e vëzhgimit ajror; Shef i qendrës së vëzhgimit ajror; Zv/Shef i qendrës së vëzhgimit ajror; Komandant radari; Shef seksioni i përpunimit të të dhënave; Nënoficer i kontrollit të ekranit RD (radarit); Nënoficer i përpunimit dhe transmetimit të informacionit; Nënoficer i teknikës speciale; Teknik mirëmbajtje për radarët; Ushtarakë në Qendrën Operacionale të Vëzhgimit Ajror. Në Qendrën Operacionale të Sovranitetit Ajror: Shefi i Qendrës Operacionale të Sovranitetit Ajror; Shefi i seksionit të drejtimit; Specialist ndërlidhje; Specialist i kontrollit të trafikut ajror; Specialist për mbrojtjen ajrore.	3,000
7	Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Të gjitha funksionet organike, në përbërje të të cilave është emërtimi “operator”; Teknik kabllist i rrjetit të brendshëm; Kabllist; Specialist i linjave telefonike; Kryeoperator; Baterist; Saldator i saldimit me oksigjen; Laborant kimist; Specialist laborant kimist; Shofer autoboti karburanti; Elektracist; Telefonist i qendrës së ndërlidhjes; Ushtarakët e kompanive (qendrave) të ndërlidhjes që punojnë në tunele; Shef radiostacioni; Elektroaut baterist; Elektroakumulorist; Radist; Centralist; Nënoficer i radios; Radiorelist; Radiometrist; Magazinier i lëndëve helmuese luftarake; Shef i PVQ (pikë vrojtimi qendrore); Specialist riparim/mirëmbajtje të mjeteve kompjuterike; Specialist i administrimit të rrjeteve kompjuterike. Në Forcat Tokësore: Instruktor teknike (tanke). Në Forcat Ajrore: Specialist për vlerësim me mjete radioteknike; Ushtarakët në shërbimin meteorologjik; Ushtarakët e mirëmbajtjes në skuadrilje dhe në qendrat e mirëmbajtjes; Shef zbulimi në komandën e shtabin e Forcës. Në sektorin e kontrollit kolaudimit në laboratorin e analizave kimike në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: Shofer mekanik. Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Mjek specialist në specialitet e terapisë; Mjek kirurg në specialitet e kirurgjisë; Mjek mikrobiolog; Mjek higjienist dietolog; Mjek në poliklinikë; Mjek stomatolog; Kirurg maxiofacial; Otorinolaringolog; Okulist; Mjek ortoped traumatolog; Kryeinfermier; Kryeinfermier i përgjithshëm; Infermier; Farmacist; Laborant në shërbimin e mikrobiologjisë. Ushtarakët në Orkestrën Frymore të Forcave të Armatosura. Në strukturat xheniere: Specialist duralumini; Agregatist. Në Forcat Detare: Oficer shtabi për lokacion; Specialist analize informacioni sigurisë; Specialist lokacioni, analize informacioni siguri; Nënoficer mirëmbajtjes vëzhgimit detar; Shef ndërlidhje lokacioni; Specialist/operator lokacioni; Komandant, Zv/komandant, Shef organi në anije; Teknik riparues lokacioni; Komandant skuadre lokacioni; Radist; Radiometrist; Specialist SUE (stacion ushqimit elektrik); Komandant kompanisë vëzhgimit detar; Komandant PRT (poste radioteknike); Nënoficer analize informacioni; Motorist; Kryemotorist; Përgjegjës kuverte; Mitrulier në anije; Infermier në anijen polumbare; Hambarist; Elektracist; Kaldaist; Kuzhinier në anije; Ushtarakë në dokun lundruar të kantierit i riparimit të anijeve. Në Arkivin Qendror: Arkivist; Shef i laboratorit të mikrofilmit. Në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes: Ushtarakë në zyrën e mbështetjes teknike. Në Qendrën e Mirëmbajtjes në Detashmentin Ajror: Komandant qendre mirëmbajtje;	2,200



	Zv/komandant qendre mirëmbajtje; Specialist radio e pajisjeve speciale; Shef seksioni shfrytëzimi; Shef seksioni specialiteve; Shef seksioni mirëmbajtje; Nënoficer shfrytëzimi; Nënoficer pajisjeve Speciale Radio Armatime. Kompania e riparimeve në batalionin logjistik të Forcave Ajrore: Komandant i kompanisë; Shef i seksionit riparim armatimit; Shef i seksionit riparim auto; Shef i seksionit riparimit radar-ndërlidhje; Specialist për SDT (stacion drejtimi topave), ADZAKA (aparati i drejtimit zjarrit artillerisë kundër ajrore), RDKA (raketa drejtimit kundër ajror), ISPIL (instrumente të lëvizshme të raketave); Shef i seksionit rigjenerimit karburantit special; Laborant i analizave karburantit special; Laborant karburanti special avioni. Në Qendrën stacionare të ndërlidhjes të Agjencinë e Sistemeve ë Ndërlidhjes e Informacionit: Komandanti; Zëvendëskomandanti; Nënoficer për furnizimin; Specialist teknik. Në Bazën e Riparimit të Aviacionit: Specialist në sektorin e kontrollit të cilësisë e laboratorit; Shef i kontrollit mekanik dhe sigurimit teknik; Shef/specialist mekanik; Shef/specialist përpunues; Shef i riparimit të aggregateve hidraulike; Shef/specialist i riparimeve elektrike; Shef/specialist riparim motori; Shef/specialist prodhimi tornitor; Shef/specialist galvanizimi; Shef/specialist riparimi elektrogazi. Në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes: Operator radiozbulues në Qendrën e Radiozbulimit. Në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake: Specialist topogjeodet; Ushtarakë në seksionin e laboratorit dhe shtypit.	
8	Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Shofer autoambulance; Shef karrofiçine; Fotograf; Bojaxhi; Marangoz; Specialist druri; Specialist duralumini; Veteriner; Specialist mirëmbajtje (mekanik, tornitor, kovaç, motorist, frezator, xhenerik, hekurkthyes; ribatinist); Specialist/nënoficer mbrojtjes konder kimike/MADM; Specialist në kartotekë; Telefonist i qendrës ndërlidhjes; Shef shëndetësisë; Mjek; Farmacist; Ndihmësfarmacist; Ndihmësmjek; Infermier; Kryeinfermier; Arkivist; Specialist arkivi; Shef sekretarisë, shifrës dhe arkivit; Shef i sektorit të administrimit të dokumentave; Ushtarakë në sektorin e evidencë (kartotrekës) në Shtabin e Përgjithshëm. Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Teknicien i përgatitjes edukimit shëndetësor; Magazinier; Nënoficer furnizimi. Në të gjitha strukturat xheniere: Hekurkthyes; Ndihmëshekurkthyes. Në qendrën e Mirëmbajtjes në Detashmentin Ajror: Specialist elektrogazi dhe furnizimi; Specialist shfrytëzimi; Nënoficer shfrytëzimi; Specialist radio; Specialist armatimi; Specialist pajimeve speciale. Në Batalionin e Vëzhgimit Ajror: Mekanik; Specialist auto; Nënoficer për riparimin e teknikës; Komandant i skuadrës së transportit e mirëmbajtjes; Specialist mirëmbajtje. Në Forcat Detare: Komanda e shtabi i flotiljeve; Komanda e grupeve lundruese; Në Shtabin e Distriktit Detar: Komandant; Zv/komandant; Shef shtabi; Shef operacioneve; Shef zbulimi; Shef ndërlidhje; Specialist lundrimi. Ushtarakë të tjerë në Qendrën e Bashkuar Operacionale. Në Qendrën Kulturore të Forcave të Armatosura: Ushtarak në grupin artistik.	1,500
9	Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Saldator me elektrik; Kryekuzhinier; Kuzhinier; Kaldaist; Specialist mirëmbajtje (gomist, saldator, axhustator, grasatorist, lavazhier, hidraulik).	800

**VENDIM****Nr. 225, datë 21.3.2017**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 432, DATË 13.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të neneve 8 e 22 të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit” dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 432, datë 13.7.2007, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr. 2, “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas klasifikimit të funksioneve, për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i

bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 7 riformulohet, si më poshtë vijon:

“7. Punonjësve të Shërbimit Informativ të Shtetit, që marrin pagën sipas niveleve të klasifikimit të këtij vendimi, u jepet shtesë për vështirësi vendi dhe zone:

a) Për punonjësit e klasave 1.1 deri 1.4, të nivelit I, të lidhjes nr. 1, në masën deri në 30% të pagës bazë mujore;

b) Për punonjësit e klasave 1.5 dhe 1.6 të nivelit I, si dhe për punonjësit e niveleve II, III dhe IV, të lidhjes nr. 1, në masën deri në 50% të pagës bazë mujore.

Masa e shtesës për çdo vend pune brenda kufijve si më sipër, vështirësia e funksionit si dhe kriteret për përfitimin e shtesës mbi pagë përcaktohen me urdhër të drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.”

2. Efektet financiare të këtij vendimi, për shkak të politikës për rritjen e pagave, të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikat e reja të pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

LIDHJA NR. 2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE SIPAS KLASIFIKIMIT TË FUNKSIONEVE, PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHETIT

Nivelet e klasifikimit	Klasifikimi i punonjësve sipas niveleve	Klasa për çdo nivel klasifikimi	Paga bazë mujore për klasë në lekë	Shtesa për Vjetërsi në %	Shtesa për gradë në %
1	2	3	4	5	6
I	Punonjës mbështetës	I.1	30000	1%	2%
		I.2	31600	1%	2%
		I.3	35000	1%	3%
		I.4	38500	1%	5%
		I.5	43600	1%	6%
		1.6	45000	1%	6%
II	Punonjës të nivelit zbatues	II.1	48000	1%	8%



		II.2	52000	1%	12%
		II.3	54000	1%	12%
III	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	III.1	57000	1%	14%
		III.2	59000	1%	16%
IV	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	IV.1	63000	1%	20%
		IV.2	68100	1%	20%
Jashtë klasifikimit	Inspektor i Përgjithshëm në SHISH		134000	0%	0%

VENDIM

Nr. 226, datë 21.3.2017

**PËR FINANCIMIN E KOSTOS SË
MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE QË
ZBATOHEN NGA FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 50 e 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe të neneve 6, pikat 2, shkronja “a”, e 4, dhe 8, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e koston së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të cilat nuk e kanë të parashikuar këtë kosto në marrëveshjet përkatëse të financimit. Kjo kosto është në masën 3% mbi vlerën totale të financimit të çdo programi/projekti.

2. Për vitin 2017, kjo kosto është jo më shumë se 173 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë) lekë dhe përballohet nga zëri i koston lokale të miratuar në buxhetin e vitit 2017, për Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 227, datë 21.3.2017

**PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE NË NJËSITË E
QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2017, shtohet me 6 veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 71 punonjës.

2. Numri i punonjësve të Ministrisë së Zhvillimit Urban, për vitin 2017, shtohet me 4 veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 539 punonjës.

3. Numri i punonjësve të Komisionit të Prokurimit Publik, për vitin 2017, shtohet me 8 veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 30 punonjës.

4. Numri i punonjësve të Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, për vitin 2017, shtohet me 5 veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 15 punonjës.

5. Numri i punonjësve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për vitin 2017, reduktohet me 18 veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 3 014 punonjës.

6. Numri i punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për vitin 2017, reduktohet me 5 veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të këtij institucioni në 1 996 punonjës.



7. Ngarkohen institucionet e përmendura më sipër dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 228, datë 21.3.2017

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, pika 3, e 18, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në nënndarjen “Lista e individëve të shpallur sipas procedurës së brendshme të shpalljes”, shtohen individët në përputhje me listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Zbatimi i këtij vendimi bëhet nga autoritetet përgjegjëse të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)

LISTA E INDIVIDËVE TË SHPALLUR SIPAS PROCEDURËS SË BRENDSHME TË SHPALLJES

1. ALDO KOBUZI, i biri i Alfred dhe i Donika, i datëlindjes 17.7.1991;
2. MARIA GIULIA SERGIO (bashkëshorte e Aldo Kobuzi), e datëlindjes 23.9.1987;
3. SERJOLA KOBUZI e bija e Alfred dhe e Donika, e datëlindjes 25.2.1996;
4. DONIKA ÇOKU (KOBUZI) e bija e Hetem dhe e Fiqirete, e datëlindjes 16.5.1971;
5. BAKI ÇOKU i biri i Hetem dhe i Fiqirete, i datëlindjes 19.9.1975.

VENDIM

Nr. 229, datë 21.3.2017

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN NË DISA NJËSI TË QEVERISJES QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet buxhetore, të miratuara në buxhetin e vitit 2017 për Ministrinë e Zhvillimit Urban, në programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, rishpërndahen në disa institucione qendrore, që janë autoritete kontraktuese, për financimin e projekteve në vazhdim, të infrastrukturës vendore dhe të programit “Shqipëria dixhitale”, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Financave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale dhe



Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet
në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA NR.1

RISHPERNDARJA E FONDEVE BUXHETORE PËR PROJEKTET NË VAZHDIM TË FZHR,
PËR NJËSITË QENDRORE

Entiteti	Kodi i institucioneve	Kodi i institucionit	Kapitulli	Programi	Llog. ekon.	Kodi i Thesaurit	Kodi i projektit	Shuma	ne leke
001_94	1094001	Aparati i MZHU	01	06210	2310000	3535	M0940115	625,400,757	Fondi i Zhvillimit të Rejoneve
Totali i pakësimeve									625,400,757
PAKËSOHET									
001_56	1056001	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	01	06210	2310000	3535	M560410	9,185,883	Rikonstruksioni i rrugës Bajram Curri - Vënicë
001_56	1056001	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	01	06210	2310000	3535	M560411	124,632,553	Sistemi i asfaltimit i rrugës së Unazës Morë (Poliklinika 7, Pallatet)
001_56	1056001	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	01	06210	2310000	3535	M560407	157,716,221	Rikonstruksioni i Rrugës "Dhimitër Kononi", Morë
001_87	1087018	Agjencia për Zbatimin e Reformave Territoriale	01	06210	2310000	3535	M870157	2,879,800	Sistemi i Menaxhimit të Aktivit dhe Protokolli në Njësitë e Qeverisë Vendore dhe Infrastruktura për Digitalizimin e Dokumentave të këtyre Njësive.
001_3	1003016	AKSHI	01	06210	2310000	3535	M030077	666,000	Promovim dhe vendosje sportive të dhjetorale për portalin e-Albania (Faza Pilot)
001_3	1003016	AKSHI	01	06210	2310000	3535	M030083	68,340,500	PLATFORMA QEVERITARE E NDERVEPRIMIT
001_3	1003016	AKSHI	01	06210	2310000	3535	M030084	261,980,000	Rindërtimi dhe modernizimi i 51 proceseve të punës GZG. Zgjerimi me 21 stacione të reja elektronike GZG. GZG dhe GZB dhe shërbime të reja në portalin qeveritar e-Albania.al
001_3	1003016	AKSHI	01	06210	2310000	3535	M030084	261,980,000	Versioni 1.0
001_3	1003016	AKSHI	01	06210	2310000	3535	M030084	261,980,000	Rritja e sigurtisë fizike dhe dixhitale në shkollat të arsimit të mesëm, ndërtimi i platformës multidimensionale të komunikimit.
Totali i shesave									625,400,757

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë